

VENDIM
Nr. 192, datë 4.3.2020

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 177, DATË 25.2.2015, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN “RSM”, NË SHTABIN E
TRAJNIM-KËSHILLIMIT DHE TË NDIHMËS, NË KUADËR TË INICIATIVËS SË
KARTËS SË ADRIATIKUT, NË AFGANISTAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe të kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fjalía e parë e pikës 3, të vendimit nr. 177, datë 25.2.2015, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri më 1 mars 2025.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama